



RREGULLORE NR. 2001/32

PËR THEMELIMIN E ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PENGUT

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autoritetin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të datës 25 korrik të vitit 1999, të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Pushtetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren nr. 2000/63 të datës 7 dhjetor 2000 të UNMIK-ut mbi Themelimin e Departamentit Administrativ të Tregtisë dhe Industrisë,

Në përputhje me Rregulloren nr. 2001/5 mbi pengun të datës 7 shkurt 2001,

Me qëllim të themelimit të një Zyreje të Regjistrimit të Pengut,

Shpall sa vijon,

Neni 1
Zyra e Regjistrimit të Pengut

1.1 Me anë të kësaj Rregulloreje themelohet Zyra e Regjistrimit të Pengut (në tekstin e mëtejme “Zyra”). Zyra do të veprojë në kuadër të Departamentit të Përkohshëm të Tregtisë dhe Industrisë ose të organit qeveritar që vjen pas tij në kuadër të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes të themeluara konform Rregullores nr. 2001/9 të UNMIK-ut të datës 15 prill 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe Rregullores nr. 2001/19 të UNMIK-ut të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (në tekstin e mëtejme “Departamenti”).

1.2 Zyra është përgjegjëse për pranimin, dorëzimin dhe arkivimin e të dhënave përkitazi me pengun e pronës së luajtshme dhe ofrimin e mundësive publikut për kërkim të pengut si dhe për mbajtjen e të gjitha shënimeve përkatëse konform Rregullores nr. 2001/5.

Neni 2
Funksionet

2.1 Zyra ka këto funksione:

(a) bën paraqitjen e deklaratave që njihen si deklarata njoftimi, e që përmbajnë të dhëna mbi ekzistimin e pengut;

(b) regjistron dhe përpilon indeksin e deklaratave të njoftimeve dhe i rendit ato deklarata sipas përparësisë në bazë të kohës dhe datës së dorëzimit të deklaratave të tilla;

(c) mbledh një taksë për paraqitjen e çdo deklarate të njoftimit dhe për çdo shërbim tjetër lidhur me të, që caktohet në përputhje me tabelën e taksave të përcaktuara nga Departamenti;

(ç) sipas rastit, njofton edhe refuzimit e paraqitjes së një deklarate njoftimi atëherë kur deklarata nuk përputhet me procedurat dhe kushtet e Zyrës së Regjistrimit të Pengut;

(d) ofron raporte me shkrim nga baza e të dhënave të veta për deklaratat e paraqitura duke u mbështetur në logjikën e kërkimit që zbatohet në përputhje me kriteret e ofruara nga kërkuesi;

(dh) ofron kopje të deklaratave të njoftimit ashtu siç paraqiten kur janë dorëzuar fillimisht në Zyrën e Regjistrimit të Pengut;

(e) përpilon, arkivon dhe ofron raporte statistikore, udhëheqëse dhe financiare për përdorimin nga Departamenti sipas kërkesës së atij Departamenti;

(ë) ofron një sistem të nxjerrjes së informacioneve publike duke përfshirë edhe shfrytëzimin e rrjeteve kompjuterike të komunikimit ndërkombëtar, telefonit, faksit dhe ndihmës në zyrën përkatëse;

(f) u ofron vërtetime për pranimin e çdo deklarate të njoftimit subjekteve që parashtrojnë deklarata të tilla;

(g) në rastet ku shrytëzohen rrjetat kompjuterike të komunikimit ndërkombëtar Zyra ofron:

- (i) një metodë të sigurt për krijimin e llogarive të shfrytëzuesve;
- (ii) qasje për mënyrat e bartjes së të dhënave drejtpërsëdrejti në Zyrën e Regjistrimit të Pengut me qëllim të paraqitjes së deklaratave të njoftimit, ndryshimeve dhe deklaratave për vazhdimin e njoftimeve dhe shkëputjen e deklaratave;
- (iii) ofron kërkesa për kërkim dhe raporte në internet;
- (iv) teste të automatizuara për verifikim sipas standardeve të kërkuar nga Departamenti;

- (v) mundësi për kërkim të plotë dhe kohë pas kohe mundësi të tjera të kësaj natyre sipas kërkesës së Departamentit dhe
- (vi) kryen funksione të tjera ndihmëse që janë parashtruar më lart, të cilat mund t'i caktohen Zyrës.

Neni 3

Drejtoria dhe administrata e Zyrës për Regjistrimin e Pengut

Departamenti është përgjegjës për udhëheqjen administrative të Zyrës duke përfshirë edhe rregullimin e personelit në përputhje me procedurat përkatëse.

Neni 4

Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 5

Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 6 nëntor 2001.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm